



iSIGURT.al

PLATFORMA KOMBËTARE PËR SIGURINË NË INTERNET
Linja Kombëtare për Internet në Sigurt për Fëmijët

ORË NDËRGJEGJËSUESE PËR INTERNETIN E SIGURT

në kuadër të

Ditës Ndërkombëtare për Internet të Sigurt (SID 2024)

Dita e Internetit të Sigurt (SID) organizohet çdo vit në muajin shkurt për të promovuar përdorimin e sigurt dhe pozitiv të teknologjisë dixhitale, veçanërisht midis fëmijëve dhe të rinjve. Në Shqipëri, dita organizohet nga Platforma Kombëtare për Internet në Sigurt (www.iSIGURT.al), anëtare e INHOPE dhe Insafe, organizatorë të ditës në nivel Europian dhe global. Në të gjithë botën, miliona njerëz bëhen së bashku për të sjellë ndryshime pozitive në internet dhe për të rritur ndërgjegjësimin për çështjet e sigurisë. Edhe ju mund të luani rolin tuaj në këtë drejtim!

Platforma Kombëtare për Internet më të Sigurt në Shqipëri (iSIGURT.al) punon për të fuqizuar fëmijët, prindërit, mësuesit dhe qytetarët për përdorim më të mirë dhe pozitiv të internetit dhe formave të tjera të komunikimit, ndërkohë që vepron si Linjë Kombëtare Hotline për Sigurinë në Internet për raportimin e imazheve me përmbajtje të dhunës seksuale ndaj fëmijëve, gjuhën dhe krimet e urrejtjes, bullizmin, dhunën dhe ngacmimet online ndaj fëmijëve etj.

Qëllimi:

1. Të kuptojmë çfarë është siguria në internet;
2. Të diskutojmë çfarë është dhuna, bullizmi dhe abuzimi online, si dhe risqe të tjera;
3. Të mësojmë cilat janë mekanizmat dhe format e raportimit të incidenteve online;

Objektivat:

1. Ndërgjegjësimi i nxënësve për lundrimin e sigurtë në Internet;
2. Informimi i nxënësve mbi risqet me të cilat përballen në internet;
3. Të nxënit e nxënësve mbi rëndësinë dhe mekanizmat e raportimit të incidenteve në internet;

Organizimi i Orës Ndërgjegjësuere:

“Si të jemi të sigurtë dhe të raportojmë incidentet që ndeshim gjatë navigimit në internet”

Kohëzgjatja: (45 min)

Mjetet: Fletëpalosje, video, laptop, etj

Për të përfituar vëmendjen e nxënësve që në fillim dhe të sigurohemi se do të kemi përqëndrimin e tyre të mëvonshëm mund të nisim orën me një ushtrim “Energjizues - Nxitës”. Pasi vëmë re se fëmijët ndihen të gatshëm për t’u angazhuar, kalojmë në bashkëbisedim me ta, duke u fokusuar tek mendimet dhe opinionet e tyre.

Gjatë diskutimit vijojmë me pyetjen e cila përgjithësisht ngjall interes tek nxënësit: **INTERNETI!**

- *A keni dëgjuar për Ditën Ndërkombëtare të Internetit të Sigurt? (Këtu mund të prezantohet imazhi kryesor i fushatës SID2024 në nivel global)*
- *Për çfarë e përdorin më së shumti internetin?*
- *Cilat janë aspektet pozitive të përdorimit të internetit?*
- *Po ato negative? (Këtu mund të prezantohen video “Historia e Anës” dhe rreziqet me të cilat përballen fëmijët online, të shkruara tek udhëzuesi i mësuesit – shiko burimet në fund të këtij dokumenti)*
- *Sa orë qëndroni në internet dhe për çfarë e përdorni internetin më së shumti? Lojëra? Chat me shokët / shoqet? Për të dëgjuar muzikë? Parë video? Bërë detyrat? Për të lexuar lajmet?*
- *A keni rrjete sociale dhe cilat përdorni më shumë? Pse?*
- *A keni patur ndonjë incident gjatë navigimit në internet dhe nëse mund të tregoni për të? Nëse nuk të ka ndodhur ty, mbase shokut apo shoqes suaj?*

Qëllimi është të kuptojmë lidhjen që kanë fëmijët me lundrimin në internet, sa kohë shpenzojnë, cilat janë platformat që përdorin dhe nëse janë përballur me rreziqe në to. Këtu bashkëbisedojmë sërish për të vendosur elementët pozitivë dhe negative të rrjeteve sociale, si dhe për të kuptuar se deri në cilin nivel të riskut janë ata të gatshëm të vijojnë të qëndrojnë ende online apo të raportojnë për një incident.

Në pjesën e dytë të orës, i pyesim nxënësit si veprojnë ata në rastet kur hasin probleme, që ata mund t’i kenë treguar nga ndodhitë e ndeshura në rrjete sociale etj. Disa pyetje që mund të përdoren për të nxitur diskutimin:

- *Si mund të mbrohemi nga incidentet online?*
- *Ku mund të raportojmë?*
- *A keni folur për këtë incident me mësuesin kujdestar apo prindin tuaj? Tjetër?*

Këtu është momenti, kur mësuesi mund t’i shpjegojë dhe informojë për rolin që ka:

iSIGURT.al

ALO 116 111

Policia

Është e rëndësishme të shpjegohet se platforma iSIGURT.al është Platforma Kombëtare për Sigurinë në Internet. Analistët e platformës, analizojnë çdo rast dhe kanë kontakte të drejtpërdrejta me të gjitha platformat në rrjetet sociale si: META, TIKTOK, SNAPCHAT, YOUTUBE, GOOGLE duke kërkuar fshirjen apo mbylljen e adresave të caktuara në varësi të kërkesës së çdo raportuesi. Vlen të theksojmë se konfidencialiteti është elementi kryesor në platformën iSIGURT.al që shqyrton, analizon dhe kryen

raportimet në një mjedis të veçantë, për tu siguruar se çdo raportim kryhet në kushtet e mbrojtjes dhe sigurisë të të dhënave personale.

Pse është e rëndësishme të raportojmë? Cilat janë ndihmat që na jepen?

I shpjegojmë fëmijëve që interneti është pjesë e përditshmërisë të gjithsecilit prej nesh, por ndonjëherë na ndodh të biem pre e dhunës online. Për tu ndjerë më të sigurtë, të qetë dhe të mbrojtur nga rreziku online, platforma iSIGURT.al na ofron mundësinë të raportojmë çdo imazh, foto, video që na dëmton neve apo shokët/miq të tanë.

Si mund të raportojmë?

Klikojmë faqen www.isigurt.al - nga celulari ose tableta. Në faqen kryesore dallohen lehtësisht dy rubrika:

- **RAPORTO** FOTO APO VIDEO SEKSULE TË FËMIJËVE, DHUNË, NGACMIME, BULLIZËM APO KËRCËNIME NË INTERNET
- **RAPORTO** GJUHË URREJTJE NË INTERNET

(Platforma mund t'ju tregohet fëmijëve vizualisht dhe ata mund të kryejmë një raportim të pavlefshëm {test} duke u shpjeguar mënyrën e raportimit dhe të dhënat që ata duhet të shkruajnë, duke theksuar se ka shumë rëndësi të dërgohet Linku i faqes apo profilit pwr tw cilin ankohen, Rrjeti Social ku ka ndodhur incidenti dhe shqetësimi i tyre – ngacmimi qw ka ndodhur etj.)

Si mund ta bëjmë internetin më të sigurtë për fëmijët?

Në përfundim të orës ndërgjegjësuese, i pyesim fëmijët se si të gjithë së bashku mund ta bëjmë internetin më të sigurtë për ta? Organizatori i orës mund ti mbledhë këto mendime dhe mund ti ndajë si me ministrinë ashtu edhe me iSIGURT pasi zgjidhjet e dhëna nga vetë fëmijët mund të jenë edhe më të mirat për t'u zbatuar.

Materiale ndihmëse për mësuesin

Video: **Historia e Anës** (www.youtube.com/watch?v=OsO21IIC1LY)

Udhëzues për mësuesin: www.isigurt.al/sherbime/udhezime-per-mesuesit

Udhëzues për Fëmijët: www.isigurt.al/sherbime/udhezime-per-femijet

Udhëzues për Prindërit: www.isigurt.al/sherbime/udhezime-per-prinderit

Informacion për SID 2024:
(Në Anglisht) <https://www.saferinternetday.org/>



Materiale informuese: Broshura informuese www.isigurt.al

